

## **Emisa Isufaj**

### **Përgjegjëse/ Sektori i Statistikave dhe Analizave, ASCAL**

Emisa Isufaj ka kryer studimet në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, ku ka përfunduar ciklin e studimeve “Master i Shkencave” në mësimdhënien e lëndës së Matematikës në AML me specialitet në menaxhimin e institucioneve arsimore; metodikat e mësimdhënies; psikologji shkollore; pedagogji.

Në periudhën Shtator 2012 – Shkurt 2015, ka ushtruar profesionin e mësueses për lëndën e Matematikës, në institucione publike dhe private të arsimit parauniversitar, duke patur si aktivitete kryesore dhe përgjegjësi në ushtrimin e kësaj detyre: mentorimin e nxënësve; planifikimin dhe përgatitjen e aktiviteteve të mësimdhënies dhe mësimnxënies; komunikimi, konsultimi dhe bashkëpunimi me prindërit në interes për më të mirën e nxënësve.

Prej muajit Shkurt 2015, është pjesë e stafit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, fillimisht pranë Sektorit të Shërbimeve dhe Publikimit ku ka realizuar detyra të rëndësishme që lidhen me: menaxhimin e korrespondencës së ASCAL me institucionet e tjera, administrimi i dokumentacionit në përputhje me aktet ligjore për arkivat në RSh, menaxhimi i marrëdhënieve me publikun, përditësim i informacionit për website zyrtar të Agjencisë.

Në vitin 2016, znj. Isufaj është angazhuar pranë Sektorit të Statistikave dhe Analizave në ASCAL, ku ka qënë e përfshirë: në proceset e akreditimit institucional zhvilluar me Agjencinë Britanike QAA, dhe të programeve në institucionet e arsimit të lartë; në menaxhimin dhe analizën e të dhënave për IAL-të; përgatitjen e raporteve analitike; menaxhimin e databazës së të dhënave të ASCAL; mbajtjen e komunikimeve me institucionet e arsimit të lartë; përditësimin e web të institucionit si dhe në organizimin e pyetësorëve përmes platformës online.

Znj. Isufaj ka qënë pjesëmarrëse në trajnime, workshop/seminare, aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare në kuadër të sigurimit të cilësisë, dhe aspekte të tjera në fushën e arsimit të lartë, gjithashtu ka qënë staf organizues dhe referuese në aktivitete që ka zhvilluar ASCAL.

Prej vitit 2018, znj. Isufaj drejton Sektorin e Statistikave dhe Analizave/ASCAL.